



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
DREJTORIA E KURRIKULËS DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I KURRIKULËS VLERËSIMIT INSTITUCIONAL DHE ALUMNI

Korçë, më 29/06/2023

RELACION PËR PYETËSORIN STUDENTOR

Në periudhën prill-maj 2023, Keshilli Studentor, anëtarët e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me Sektorin e Kurrikulës Vlerësimit Institucional dhe Alumni kanë zhvilluar pyetësin studentor, pyetjet e të cilit janë hartuar dhe rishikuar sipas përcaktimeve ligjore.

Pyetësi është shpërndarë në teren nga anëtarët e Këshillit Studentor.

Pas përfundimit të periudhës së caktuar për plotësimin e tij, të dhënat e mara janë filtruar sipas fakulteteve dhe u janë dërguar koordinatorëve të njesisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë për secilin fakultet të cilët bënë raportet përkatëse.

Përkatësisht pyetësi u plotësua nga **731** studentë pjesëmarrës nga 2655 studentë të UNIKO, ku **296** studentë ishin nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane nga 1038 studentë të këtij fakulteti, **270** nga Fakulteti i Ekonomisë nga 728 studentë të këtij fakulteti, **109** nga Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë nga 587 studentë të këtij fakulteti dhe **56** nga Fakulteti i Bujqësisë nga 302 studentë të këtij fakulteti . Në total rezulton se pyetësi është plotësuar nga **27.5%** e studentëve aktualë për vitin akademik 2022-2023.

Nga shpërndarja e pyetësit kemi marrë të dhëna nga të gjitha ciklet dhe vitet e studimit si edhe nga të gjitha programet e studimit.

Zhvillimi i mësimi ose vlerësimit të bazës mësimore (tekste bazë, tekste ushtrimesh, literaturë ndihmëse, internet, bibliotekë)

Rreth zhvillimit të mësimi ose të vlerësimit të bazës mësimore (tekste bazë, tekste ushtrimesh, literaturë ndihmëse, internet, bibliotekë), nga rezultatet e nxjerra nga ky pyetësor, nëse bëjmë një mesatare të përgjigjeve vihet re që studentët janë përgjigjur pjesa më e madhe e tyre me “**MJAFTUESHËM**” dhe “**MIRË**”.

Performanca e pedagogëve

Pyetjet përbëhen nga pesë kriterë vlerësimi, duke përfshirë përdorimin e metodave të efektshme të mësimdhënies, atmosferën në auditor, kompetencat profesionale të pedagogut, menaxhimin e kohës gjatë orëve mësimore dhe vlerësimin e studentëve.

Përqindja më e lartë e përgjigjeve në të gjitha aspektet është “MIRË” në masën 40-45%, që do të thotë se pavarësisht performacës pozitive ka vend për përmirësim.

Raste pedagogësh që kanë performancë negative

FB nuk ka asnjë rast të përmendur

FEF 109 gjithsej/ 9 komente/ 100 pa përgjigje

FE 270 gjithsej/ 66 komente/ 237 pa përgjigje

FSHNSHH 128 gjithsej/ 11 komente /116 pa përgjigje

DEP. INF 168 gjithsej/ 43 komente/ 105 pa përgjigje

Raste të orëve të mësimit të pazhvilluara

FB nuk ka asnjë rast të përmendur

FEF 109 gjithsej/ 4 komente/ 105 pa përgjigje

FE 270 gjithsej/ 75 komente/ 224 pa përgjigje

FSHNSHH 128 gjithsej/ 5 komente/ 122 pa përgjigje

DEP. INF 168 gjithsej/ 47 komente/ 105 pa përgjigje

Vlerësimi mbi literaturën e përdorur

Në përgjithësi, nga të dhënat duket se studentët kanë pjesërisht nevojë për literaturë shtesë dhe sugjerime nga pedagogët pasi në përgjithësi literatura është e mjaftueshme, por kanë hasur vështirësi në kuptimin e materialeve të dhëna. Sidoqoftë, shumica e studentëve pajtohen se përdorimi i literaturës shtesë ka ndihmuar në zgjerimin e njohurive dhe lidhjen e saj me tematikën e kursit ka qenë e rëndësishme. Gjithashtu, ata pajtohen se detyrat e kursit krijojnë aftësi praktike të dobishme.

Vlerësimi i shërbimeve të Sekretarive Mësimore, Bibliotekave dhe Infrastrukturës

Aspektet për të cilat janë pyetur studentët janë: komunikimi, sjellja, disponueshmëria, ndricimi ngrohja, aksesit në internet. Përqindja më e lartë e përgjigjeve për komunikimin sjelljen disponueshmërinë është “MIRË” 90%, ndricimi ngrohja “KEQ” 45%, Interneti “KEQ” 50%, që do të thotë se pavarësisht përpjekjeve për përmirësim të vazhdueshme në secilin aspekt ka ende vend për përmirësim.

Vlerësimi për shërbimet e bibliotekave dhe laboratoreve

Në këtë rast studentët duhet të jepni përgjigje me “ASPAK” “PAK” “PLOTËSISHT” për pyetjet e dhëna. Sipas përgjigjeve të dhëna përsa i përket mbulimit të kërkesave për literaturë, ndihmesa që jep literatura në biblioteka apo puna laboratorike për kryerjen e detyrave, sa plotësohen nevojat për zbatime praktikë në laboratorë dhe sa të disponueshme janë literaturat e pedagogëve në biblioteka përqindja më e lartë e përgjigjeve është “PAK” ndjekur nga “PLOTËSISHT”.

Me këtë nënkuptohet se mund të ketë nevojë për përmirësime në shërbimet e tyre bibliotekare dhe laboratorike. Studentët kanë identifikuar nevojën e tyre për më shumë literaturë dhe zbatim praktik në laborator, si dhe më shumë disponueshmëri të literaturave të pedagogëve në bibliotekë.

Raste të korrupsionit

Rreth 90% e studentëve e kanë mohuar mundësinë e korrupsionit ndërsa rreth 10% pohon forma dhe mënyra të ndryshme të favorizimit.

FB 100% JO

Nuk ka asnjë rast të përmendur.

FEF 95% JO 5% PO

109 gjithsej/ 2 komente/ 107 pa përgjigje

FE 80% JO 20% PO

FSHNSHH 90% JO 10% PO

128 gjithsej/ 3 komente/ 124 pa përgjigje

DEP. INF 168 gjithsej/ 10 komente/ 130 pa përgjigje

Komente të përgjithshme

FB nuk ka asnjë koment të përmendur.

FEF 109 gjithsej/ 8 komente/ 102 pa përgjigje

Përgjithësisht referuar vlerësimit jo të drejtë, mungesë higjene në auditore, sjellje jo e mirë e sekretarive, pamundësi aksesi në biblioteka dhe laboratore.

FE 270 gjithsej/ 42 komente/ 239 pa përgjigje

Komentet i referohen më së shumti vlerësimit jo të drejtë, të ketë më shumë mirëkuptim midis pedagogut dhe studentëve, shpjegimi i leksioneve po bëhet i mërzitshëm në më të

shumtën e rasteve ku lexohen vetëm slide-t në Poëer Point, të ketë më shumë orë dhe punë praktike, të ketë më shumë monitorime, pamundësi aksesit në internet.

FSHNSHH 128 gjithsej/ 12 komente/ 115 pa përgjigje

Komentet i referohen më së shumti vlerësimit jo të drejtë, të ketë më shumë mirëkuptim midis pedagogut dhe studentëve, të ketë më shumë monitorime, pamundësi aksesit në internet dhe në laboratore.

DEP. INF 168 gjithsej/ 37 komente/ 112 pa përgjigje

Pakënaqësi rreth vlerësimit jo të drejtë, pakënaqësi rreth atmosferës së krijuar në auditore, pamundësi aksesit në internet dhe në laboratore, korrupsioni.

REKOMANDIME NGA FAKULTETET

Fakulteti i Bujqësisë

Disa hapa që mund të ndiqen për të përmirësuar situatën janë:

-Identifikimi i nevojave të studentëve dhe pedagogëve: Një analizë e hollësishme e nevojave të studentëve dhe pedagogëve mund të ndihmojë në përcaktimin e fushave ku nevojiten përmirësime. Kjo mund të bëhet përmes anketave, bisedave dhe konsultimeve me ta.

-Investimi në teknologji dhe mjete mësimore: Përdorimi i teknologjisë dhe mjeteve mësimore bashkëkohore mund të ndihmojë në përmirësimin e mënyrës së mësimit dhe të kuptimit të mësuesve dhe studentëve.

-Trajnimet për pedagogët për përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve mësimore bashkëkohore mund të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimit.

-Investimi në infrastrukturën e rrjetit dhe lidhjen me internetin mund të ndihmojë në përmirësimin e aksesit të studentëve dhe mësuesve në burime të ndryshme të informacionit dhe teknologjisë.

-Pedagogët mund të punojnë për të përmirësuar metodat e tyre mësimore dhe për të përdorur teknologjinë dhe burimeve të reja për të ndihmuar studentët të mësojnë më mirë dhe të bëjnë përpjekje për të krijuar një atmosferë mësimore më të rehatshme dhe miqësore për studentët, në mënyrë që ata të ndjehen më të motivuar dhe të përqendrohen më shumë gjatë orëve mësimore, si edhe përsa i përket vlerësimit pedagogët mund të ndjekin rregullisht vlerësimin e studentëve dhe të marrin parasysh mendimet e tyre për të përmirësuar performancën e tyre.

-Përsa i përket literaturës disa sugjerime mund të jenë: të ofrohet më shumë literaturë shtesë dhe të sugjerohet ato për studentët, duke i ndihmuar ata të kuptojnë materiale më shumë, të përdoren metoda më efektive të mësimdhënies për të ndihmuar studentët në kuptimin e literaturës dhe në aftësinë praktike të detyrave të kursit, të sigurohet që detyrat e kursit të kenë një nivel të përshtatshëm të aftësisë praktike dhe të jenë të

rëndësishme për tematikën e kursit, të kuptohet se çfarë i bën studentët të pajtohen ose jo me nevojën për literaturë shtesë dhe të ndërmerren hapa për të adresuar këto çështje, të ndërmerren hapa për të siguruar që lidhja e materialeve me tematikën e kursit të jetë e qartë dhe e ndjeshme për studentët.

-Rezultatet tregojnë se disa fusha si infrastruktura fizike dhe aksesit në internet kanë nevojë për përmirësime

-Përmirësime në aspektet e tjera të funksionimit të bibliotekës dhe sekretarisë, siç janë orët e punës, aksesimi dhe shërbimi ndaj studentëve, sjellja e komunikimit është gjithashtu një aspekt i rëndësishëm që duhet të vazhdojë të përmirësohet.

-Në fund, duhet të merren masat për të adresuar nevojat dhe kërkesat e studentëve, dhe të sigurohet se këto kërkesa marrin parasysh në planifikimin dhe vlerësimin e veprimtarive akademike. Ky proces mund të përfshijë konsultime me studentët, vlerësimin e nevojave të tyre dhe ofrimin e shërbimeve në varësi të tyre.

-Rritja e mbulimit të nevojave të studentëve për literaturë dhe burime të tjera akademike në bibliotekë, sigurimi i më shumë burimeve për nevojat e laboratorëve, siç janë pajisjet dhe materialet e nevojshme për eksperimente dhe demonstrime, rritja e disponueshmërisë së literaturave të pedagogëve në bibliotekë, duke siguruar qasje të lehtë dhe efikase për studentët, zvogëlimi i kufizimeve në aksesin në laboratorë dhe burime bibliotekare, duke siguruar qasje të lirë dhe të lehtë për studentët, promovimi i bashkëpunimit midis pedagogëve dhe studentëve për të identifikuar nevojat e tyre akademike dhe për të zhvilluar programet dhe burimet e nevojshme për të plotësuar këto nevoja, përdorimi i teknologjisë për të rritur efikasitetin dhe qasjen në shërbimet e bibliotekës dhe laboratorit, duke përfshirë sisteme të avancuara të katalogimit dhe sisteme të rezervimit online të pajisjeve dhe burimeve të laboratorit.

Fakulteti Ekonomik

Njësia e Brendëshme e Sigurimit të Cilësisë, pasi ka shqyrtuar përgjigjet e studentëve në këtë pyetësor dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve i rekomandon:

-Për të mundësuar një vlerësim më të plotë të duhet që në plotësimin e pyetësorëve në të ardhmen të punohet për të arritur një nivel më të lartë pjesëmarrje nga studentët e të gjitha programeve dhe të gjitha cikleve të studimit. Në këtë drejtim mendojmë se duhet të kërkohet më tepër mbështetje nga përfaqësues të Këshillit Studentor. Studentët duhet të kuptojnë rëndësinë që ka ushtrimi i kësaj të drejte që ju ofrohet.

-Në lidhje me literaturën në dispozicion të studentëve dhe teknologjinë e përdorur në mësimdhënie pedagogët të marrin në konsideratë vlerësimin e dhenë nga studentët dhe ta bëjnë pjesë të çështjeve që do të diskutohen në nivel njësie bazë apo edhe atë kryesore.

-Në seksionin e pyetjeve që lidhen me vlerësimin e performancës së pedagogëve, me efektshmërinë e metodave të mësimdhënies, atmosfera që krijon pedagogu në auditor, kompetencat profesionale dhe menaxhimi i kohës në auditor rekomandohet, vlerësimi i marë nga studentët nuk është ai më i mirë i mundshëm. Rekomandohet të gjendet mundësia e përfshirjes së stafit në projekte të cilat kanë në fokus përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive të ligjërimit, përdorimin e teknologjive të reja dhe modeleve të reja të mësimdhënies të cilat rrisin shkallën e pjesëmarrjes aktive të studentëve në auditor.

-Të prezantohen dhe diskutohen gjetjet e këtij pyetsori jo vetëm me personelin akademik por edhe me atë ndihmës akademik. Të diskutohet se cilat janë arsytet që qëndrimet dhe disponibiliteti i tyre perceptohet nga studentët se nuk është ai i duhur dhe se ka vend për përmirësim.

-Në përfundim të prezantimit dhe diskutimit të këtij raporti me stafin akademik dhe atë ndihmës mësimor, bazuar në gjetjet e këtij raport, të ndërtohet pema e problemeve dhe e objektivave për të planifikuar aktivitetet e duhura që u adresohen e problemeve.

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

-Në lidhje me përgjigjet e marra nga studentët për Fakultetin e Edukimit dhe të Filologjisë, nga analiza e të dhënave figuron se studentët kanë prekur problematika në disa prej fushave ku vlerësohet performanca e pedagogëve në auditor, si dhe fusha ku është e nevojshme të punohet për përmirësim. Po ashtu, vihet re një kohezion i studentëve sa i takon numrit të lartë të përgjigjeve për performancë të duhur nga stafi akademik dhe administrativ në FEF.

-Rekomandimi ynë që të gjitha çështjet në fjalë të konsiderohen me përparësi për t'u përmirësuar më tej nga stafi akademik i FEF.

-Sa i takon infrastrukturës dhe shfrytëzimit të ambienteve, është përmendur nevoja për përmirësim të kushteve të infrastrukturës dhe të ambienteve të tualeteve, dhe kjo përkon edhe me planifikimin për ndërhyrje në infrastrukturën e FEF me fonde institucionale që në vitin e ardhshëm akademik.

-Në përfundim, mund të themi se pyetësi studentor me studentë të FEF për këtë vit ka parë një angazhim më të madh të studentëve në plotësimin e pyetësorit, por përgjigjet e dhëna prej tyre në shumë raste kanë qenë të paplota dhe sipërfaqësore.

-Rekomandojmë që stafi akademik dhe administrativ i FEF të ndërveprojë dhe të nxitë studentët që të bëhen pjesë aktive e kësaj nisme të UNIKO, jo në funksion të ndëshkimit dhe të marrjes së masave, që ndonjëherë mund të jenë subjektive e të pabazuara, por në funksion të rritjes së cilësisë dhe përmirësimit të kushteve për studim në FEF.

-Të dhënat e pyetësorit tregojnë që studentët e FEF mund të trajtojnë edhe në forma specifike dhe të drejtpërdrejta shqetësimet e tyre, e ky zë nevojitet të forcohet me kalimin e kohës, për një Fakultet ku vullneti i studentëve përkon me punën e përditshme të pedagogëve dhe stafit administrativ, në të mirë të punës në universitet.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane

Nga sa u pasqyrua në të dhënat ka çështje në të cilat duhet të bëhen përmirësime:

Metodat e mësimdhënies në auditor të jenë më bashk kohore, lehtësuese dhe depërtuese të njohurive nga një nivel konceptual në atë praktik, rritja e mjeteve digjitale në procesion e mësimdhënies, përmirësimi i menaxhimit të orës mësimore nga pedagogët, rritja e ndërveprimit me studentët dhe përfshirja e tyre aktive në procesin e mësimdhënies, zgjerimi i literaturave shtesë me qëllim mirë orjentimin e studentëve drejt literaturave bashkëkohore dhe profesionale sipas lëndës përkatëse.

Problematikat kryesore të shprehura nga studentët e përfshirë në këtë anketim, theksojnë domosdoshmërinë e trajnimeve të herë pashershme të stafit mbi metodat e mesimdhënies bashkëkohore dhe mirë -integrimi në përdorimin e mjeteve digjitale në mësimdhënien produktive sot.

REKOMANDIME PËRFUNDIMTARE

-Në total rezulton se pyetësi është plotësuar nga 27.5% e studentëve aktualë për vitin akademik 2022-2023.

Kjo përqindje është më e lartë sesa në pyetësin e sezonit të kaluar por duhet të punohet që të rritet në mënyrë që edhe rezultatet e mara të jenë më të konsiderueshme dhe më të besueshme.

-Ka nevojë për përmirësim atmosferë e krijuar në auditor, respekti ndaj studentëve, vlerësimi objektiv dhe i drejtë, më shumë bashkëpunim dhe mirëkuptim midis pedagogëve dhe studentëve, përmirësimi i metodologjisë së mësimdhënies.

-Ka nevojë për përmirësim mundësia për akses në bibliotekë, laboratore dhe internet.

-Të shmangen aludimet për korrupsion, orë të pazhvilluara mësimi apo performance negative të pedagogëve nëpërmjet komunikimit me studentët që supozohet të kenë këto lloj problematikash ose të përmirësohen nëse ekzistojnë realisht.

-Të zhvillohen më shumë monitorime në dobi të krijimit të një ambjenti të sigurtë dhe motivues për studentët.

Të gjitha këto aspekte janë përmendur edhe në analizat me rekomandime të pyetësorëve të mëparshëm, për këtë arsye sugjerohet të meren masa konkrete për përmirësimin apo minimizimin e këtyre çështjeve në të ardhmen.

Saktori i Kurrikulës Vlerësimi Institucional dhe Alumni
Përgjegjës
Dr. Evis Kapurani

